

DnV: Zvarritja e emërimit të anëtarëve të KQZ-së dëmton funksionalitetin e institucionit | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA PËRBALLË NJË PROVE POLITIKE: KOMPROMIS APO KRIZË E RE?

| FAQE 4-5



Kosova po shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme për shkak të mungesës së konsensusit politik, vlerësojnë analistët. Mungesa e

kulturës së kompromisit ndërpartiak rrezikon të krijojë një cikël të pafund krizash institucionale. Për pjesën më të madhe të vitit të

kaluar, vendi ka funksionuar me qeveri në detyrë dhe Kuvend jofunksional si pasojë e mungesës së bashkëpunimit politik

OPINION

24 MARS 1998 DHE OPERACIONI LUFTARAK I ARMIKUT NË GLLOGJAN F. 7

Kudusi LAMA



EKONOMIA BOTËRORE NË PIKËN E THYERJES: KRIZA ENERGJETIKE QË PO RIKONSTRUKTON RENDIN GLOBAL F. 7

Shkruan:
Nazmi JUSUFI



AKTUALE



TRUMPI THOTË SE SHBA-ja PO BISEDON ME NJERËZIT E DUHUR NË IRAN PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS F. 7

12 AERODROMET E BRAKTISURA TË KOSOVËS F. 7

EKONOMI

LDK-ja: NJEHSORËT ELEKTRIKË MATIN GABIMISHT ENERGJINË ELEKTRIKE F. 8

SPORT



KOSOVA SONTE LUAN PËR HISTORI PËRBALLË SLOVAKISË F. 11



PDK-JA: TË MERREN MASA TË MENJËHERSHME PËR ULJEN E ÇMIMIT TË NAFTËS, QEVERIA I KA BRAKTISUR QYTETARËT F. 3



OSMANI PËR FUSHATËN KUNDËR SAJ: KUR PROPAGANDA MUND TA KTHEJË KËDO NË TRADHTAR BRENDA NATËS, DEMOKRACIA ËSHTË NË RREZIK F. 5

RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 878 | 045 500 870
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP S.H.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n. Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

TRUMPI THOTË SE SHBA-ja PO BISEDON ME NJERËZIT E DUHUR NË IRAN PËR T'I DHËNË FUND LUFTËS

UASHINGTON, 25 MARS - Presidenti Donald Trump ka thënë se Shtetet e Bashkuara po “bisedojnë me njerëzit e duhur në Iran” lidhur me një marrëveshje për t'i dhënë fund luftës, ndërkohë që Teherani kreu sulme ndaj Izraelit dhe Kuvajtit dhe mediet amerikane raportuan se mijëra trupa shesë mund të dërgohen në rajon.

Gazeta amerikane “New York Times” dhe televizioni izraelit “Channel 12” raportuan se ShBA-ja ia ka dërguar Iranit një plan paqeje me 15 pika. Ato cituan zyrtarë të pidentifikuar, ndërsa as administrata Trump e as Teherani nuk e kanë komentuar deri tani këtë plan. Trumpi i bëri këto komente të martën vonë, një ditë pasi kishte thënë se ishin zhvilluar bisedime “shumë të mira dhe frytdhënëse”, pavarësisht se figura të larta iraniane kanë mohuar se Teherani është në bisedime me Uashingtonin. “Ne, në fakt, po flasim me njerëzit e duhur dhe ata duan shumë të bëjnë marrëveshje. Nuk ia keni idenë sa shumë duan të bëjnë marrëveshje”, tha Trumpi të martën në Shtëpinë e Bardhë. “Ne jemi në bisedime tani”, shtoi ai.

Për herë të dytë brenda dy ditësh, ai tha se Irani është pajtuar se nuk do të zhvillojë kurrë armë bërthamore. Programi bërthamor i Iranit, për të cilin Teherani këmbëngul se është thjesht paqësor, është në qendër të tensioneve ndërkombëtare lidhur me këtë vend të Lindjes së Mesme.

Trumpi tha se i dërguari amerikan Steve Witkoff dhe Jared Kushner janë të përfshirë në bisedime, së bashku me nënpresidentin JD Vance dhe sekretarin e shtetit Marco Rubio. Ai nuk dha afat kohor për ndonjë takim apo telefonatë.

Trumpi nuk përmendi e as nuk zbuloi ndonjë zyrtar me të cilin Shtetet e Bashkuara po bisedojnë. Ai tha se “po merremi me një grup të ri njerëzish” pas vrasjes së liderit të kamotshëm suprem, Ali Khamenei, dhe shumë zyrtarëve të tjerë të lartë iraniane.

Trumpi tha se ky grup i kishte dhënë ShBA-së një “dhuratë shumë të madhe” që “mbërriti sot” dhe që lidhej me naftën dhe gazin. Ai nuk sqaroi se çfarë ishte, por sugjeroi se kishte

lidhje me Ngushticën e Hormuzit, rrugën e rëndësishme detare për dërgesat e naftës dhe gazit nga Gjiri Persik drejt tregjeve globale.

“New York Times”, duke cituar dy zyrtarë të pidentifikuar, tha se është “e paqartë se sa gjerësisht është shpërndarë ndër zyrtarët iranianë” plani me 15 pika për zgjidhjen e konfliktit, i cili u dorëzua përmes Pakistanit.

“Channel 12”, që citoi tri burime, tha se ShBA-ja po kërkonte armëpushim njëmuji për të diskutuar për planin, i cili, ndër të tjera, përfshinte mbajtjen e Ngushticës së Hormuzit të hapur, çmontimin e programit bërthamor të Iranit, përfundimin e mbështetjes së tij për grupet e jashtme dhe heqjen e të gjitha sanksioneve ndaj Teheranit.

Shtyrja e afatit për Ngushticën e Hormuzit

Pavarësisht se Irani po i vazhdon sulmet ndaj Izraelit, vendeve të Gjirit Persik dhe shënjestrave amerikane në rajon, njëkohësisht po mban të bllokuar Ngushticën e Hormuzit, Trumpi tha se “kjo luftë është fituar” dhe se Irani është “plotësisht i mundur.”

Të hënën Trumpi tha se Shtetet e Bashkuara dhe Irani kanë zhvilluar bisedime “shumë të mira dhe frytdhënëse” për t'i “zgjidhur plotësisht armiqësitë në Lindjen e Mesme”. Ai tha se po shtyn për pesë ditë afatin që i kishte vënë Iranit për ta hapur Ngushticën e Hormuzit.

Kryetari i Parlamentit të Iranit dhe zyrtarë të tjerë e kanë mohuar se kanë zhvilluar bisedime me ShBA-në, por raportet e medieve amerikane sugjerojnë se ka pasur të paktën kontakte fillestare mes palëve përmes ndërmjetësve.

Pas raportimeve se negociatat mund të zhvilloheshin në Pakistan këtë javë, kryeministri Shehbaz Sharif tha në rrjetet sociale të martën se vendi i tij “është i gatshëm dhe i nderuar të jetë mikpritës për të lehtësuar bisedime kuptimplota dhe përfundimtare për një zgjidhje gjithëpërfshirëse të konfliktit”. Por lufta, e cila filloi me sulmet ajrore të ShBA-së dhe Izraelit ndaj Iranit më 28 shkurt, po vazhdon me pak shenja se do të



ndalet. Mediet amerikane, duke cituar zyrtarë të pidentifikuar, raportuan se ShBA-ja po planifikon të dërgojë mijëra ushtarë nga Divizioni elitë i 82-të Ajror në Lindjen e Mesme.

“Wall Street Journal” raportoi se Pentagoni po planifikon të dërgojë një njësi luftarake prej rreth 3 000 ushtarësh nga ky divizion në rajon. Ushtarët e kësaj njësie “stërviten për të zbkruar me parashutë në territore armiqësore ose të kontestuara për të siguruar aeroporte dhe zona tokësore”, tha gazeta.

Irani kreu sulme ndaj Kuvajtit dhe Izraelit të martën, ku zyrtarët thanë se të paktën gjashtë njerëz u plagosën në Tel Aviv nga mbetjet që ranë pasi raketat dhe dronët iranianë u rrëzuan në ajër.

Përparimi diplomatik, i paqartë

Ndërkohë “Financial Times” raportoi se Irani u ka thënë shteteve anëtare të Organizatës Ndërkombëtare Detare se “anijet joarmiqësore” mund të kalojnë nëpër Ngushticën e Hormuzit nëse koordinohen me autoritetet iraniane. “Financial Times” citoi një letër

nga Ministria e Jashtme e Iranit, e cila ishte shpërndarë ndër anëtarët e IMO-së dhe që deklaronte se anijet e lidhura me ShBA-në, Izraelin dhe “pjesëmarrës të tjerë në agresion... nuk kualifikohen për kalim të pafajshëm ose joarmiqësor”.

Letra thoshte se Teherani kishte “marrë masa të nevojshme dhe proporcionale për t'i parandaluar agresorët dhe mbështetësit e tyre nga shfrytëzimi i Ngushticës së Hormuzit për të avancuar operacione armiqësore kundër Iranit”, sipas “Financial Times”. Kenneth Pollack, ish-analist i Shtëpisë së Bardhë dhe CIA-s, tani në Institutin për Lindjen e Mesme (MEI), tha se ka pak prova që mbështesin pretendimet për përparim të afërt diplomatik pavarësisht prej përpjekjeve të disa vendeve për të ndërmjetësuar bisedime. “Siç e kuptoj unë, iranianët janë përgjigjur me kushte shumë të forta paraprake: që ShBA-ja të paguajë dëmshpërblime dhe t'i tërheqë të gjitha forcat nga rajoni, gjëra që janë të papranueshme për Trumpin”, tha Pollack për Radion Evropa e Lirë në Uashington më 23 mars. “Deklaratat e Trumpit duket se kanë më shumë të bëjnë me

qetësimin e tregjeve sesa me një përparim të vërtetë dhe të afërt”, theksoi ai.

Shpërthimi i konfliktit ka bërë që çmimet e naftës të rriten ndjeshëm, veçanërisht meqë transporti është ndalur pothuajse plotësisht në Ngushticën e Hormuzit, pikën kyçe për transportin detar nëpër të cilën kalon rreth një të pestën e naftës dhe gazit botëror.

Konflikti ka tronditur tregjet e energjisë dhe ato financiare, ka rritur kostot e karburantit, ka nxitur frikë për inflacion global dhe ka destabilizuar Lindjen e Mesme dhe Perëndimin, duke shtuar shqetësimet se luftimet mund të përhapen dhe ta përfshijnë të gjithë rajonin. Kërcënimi për sulme ndaj rrjeteve elektrike në Gjirin Persik ka ngjallur frikë për ndërprerje masive të desalinizimit të ujit të pijshëm dhe ka tronditur më tej tregjet e naftës.

Komentet e Trumpit për bisedimet ndihmuan që çmimi i naftës Brent të bjerë rreth 10 për qind të hënën, megjithëse sulmet në gjithë Lindjen e Mesme të martën e rritën sërish atë rreth 3 për qind, në më shumë se 102.84 dollarë për fuçi.

PDK-ja: TË MERREN MASA TË MENJËHERSHME PËR ULJEN E ÇMIMIT TË NAFTËS, QEVERIA I KA BRAKTISUR QYTETARËT

EPOKA
ERE

Mal QORRAJ

PRISHTINË, 25 MARS - Deputeti i Partisë Demokratike të Kosovës, Arben Mustafa, ka akuzuar qeverinë Kurti se po thellon krizën ekonomike në vend duke neglizhuar rritjen e çmimit të naftës, e cila po ndikon në rritjen e çmimeve të produkteve dhe shërbimeve të tjera.

Deputeti Mustafa në një konferencë për medie tha të mërkurën se prioritet i kësaj qeverie të papërgjegjshme është vetëm mbledhja e taksave me çdo kusht, të cilat ruhen për t'u përdorur si shtesa dhe subvencione në kohë fushatash. “Sot për çdo litër naftë shteti merr rreth 60 centë taksa: 36 centë akcizë dhe 24 centë TVSh. Pra, kur një qytetar furnizohet me naftë, në çmimin prej 1.80 eurosh për litër, nuk paguan vetëm çmimin e naftës, por i paguan edhe shtetit 60 centë taksa. Kjo është një barrë që duhet të lehtësohet në këtë kohë krize. Heqja dorë përkohësisht nga këto taksa, në tërësi apo edhe pjesërisht, do të

nënkuptonte një zbritje të menjëhershme të çmimit të naftës dhe frenim të efektit zinxhior të rritjes së çmimeve”, shtoi ai.

Mustafa theksoi se pas rritjes së çmimeve në vitin 2022, Kosova nuk mund të përballojë edhe një valë tjetër të varfërimit të qytetarëve. “Rritja e çmimit të naftës nuk prek vetëm ata që furnizohen në pompë. Ajo rritë shpenzimet e transportit, të prodhimit dhe, rrjedhimisht, çmimet e të gjitha produkteve që konsumojmë. Në prag të sezonit të bujqësisë, kjo rritje godet drejtpërdrejt bujqit tanë, duke i detyruar të prodhojnë me shpenzime më të mëdha dhe, rrjedhimisht, t'i shtrenjojnë produktet e tyre”, theksoi deputeti i PDK-së.

PDK-ja kërkon ulje të menjëhershme të taksave për derivatet e naftës, në mënyrë që çmimi ta reflektojë realitetin ekonomik të qytetarëve dhe jo vetëm interesin fiskal të shtetit. “Masa konkrete dhe të drejtpërdrejta për mbrojtjen e bujqve dhe prodhuesve vendorë,



përfshirë subvencione shtesë dhe mbështetje për inputet bazë në këtë sezon kritik. Një plan emergjent, të qartë dhe të matshëm, për përballimin e rritjes së çmimeve, që garanton stabilitet për familjet dhe bizneset. Pra, një plan emergjent anti-inflacion, me objektiva konkrete për

stabilizimin e çmimeve dhe masa të koordinuara mes ministrive. Kontroll dhe transparencë në treg për t'i parandaluar abuzimet, me inspektime të shtuara ndaj çmimeve, monitorim të zinxhirit të furnizimit, penalizim të marrëveshjeve të fshehta dhe rritjeve artificiale, sepse shumë

ritje çmimesh nuk janë vetëm nga tregu, por edhe nga abuzimet”, bëri thirrje Mustafa. Ai kërkoi nga qeveria që energjinë, të cilën po e shpenzon për të krijuar apo thelluar kriza politike, ta përqendrojë në mbështetjen konkrete të qytetarëve dhe ekonomisë së vendit.

DNV: ZVARRITJA E EMËRIMIT TË ANËTARËVE TË KQZ-së DËMTON FUNKSIONALITETIN E INSTITUCIONIT



PRISHTINË, 25 MARS - Koalicioni i organizatave për vëzhgimin e zgjedhjeve “Demokracia në Veprim” (DnV) kundërshton vendimin e presidentes Vjosa Osmani për ta referuar çështjen e emërimit të anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) në Gjykatën Kushtetuese, pasi ky veprim e vonon kompletimin e institucionit në një moment kur funksionaliteti i tij është thelbësor për integritetin e proceseve zgjedhore.

DnV vlerëson se mënyra e përbërjes së KQZ-së është e përcaktuar qartë në kuadrin kushtetues dhe atë ligjor

përmes modelit strikt të përfaqësimit. “Ky model nuk lidhet drejtpërdrejtë me rezultatin zgjedhor apo peshën politike të subjekteve në kuptim të numrave, por me parimin e balancës ndërmjet grupeve parlamentare që kanë të drejtë propozimi. Si i tillë, ai zbatohet në mënyrë të njëjtë edhe në rrethanat aktuale politike, pa u riformuluar në bazë të rezultateve apo konfigurimeve tjera. Kjo qasje është reflektuar në mënyrë të qëndrueshme edhe në praktikë dhe vendimmarrjen e Gjykatës Kushtetuese. Në raste të mëhershme, përfshirë periudhën pas zgjedhjeve të

vitit 2021, përbërja e KQZ-së është përcaktuar mbi bazën e modelit strikt, duke kufizuar përfaqësimin e subjektit më të madh në dy anëtarë, pavarësisht rezultatit zgjedhor. Kjo praktikë përbën një standard - në harmoni edhe me Kodin e Praktikës së Mirë në Çështjet Zgjedhore të Komisionit të Venecias - të vendosur që ka garantuar funksionimin e balancuar të institucionit”, thuhet në reagimin e DnV-së.

DnV bën thirrje që emërimi i anëtarit të mbetur të KQZ-së të përmbillet pa vonesë të mëtejshme e në përputhje me Kushtetutën.

LDK-ja: Njehsorët elektrikë matin gabimisht energjinë elektrike

PRISHTINË, 25 MARS - Anëtari i Kryesisë së LDK-së, Visar Azemi, në një konferencë për medie ka paraqitur fakte të një skandali të madh të mashtrimit përmes njehsorëve të energjisë elektrike. Nga verifikimi në terren i 884 njehsorëve, rezultoi se 87 % e tyre e matin kohën gabimisht, duke faturuar energjinë me tarifa të shtrenjta edhe gjatë konsumimit në orët e natës, kur tarifa është me të lirën. Ai ka theksuar se ky është rezultat i dështimit të qeverisë

dhe ZRrE-së për ta monitoruar sistemin e llogaritjes së kohës në njehsorët e energjisë elektrike.

Azemi tha se përderisa qeveria i fton qytetarët ta kursejnë energjinë përmes tarifave të ulëta, ajo po i mashtron ata duke i detyruar të paguajnë me tarifa të shtrenjta.

Në këtë konferencë Azemi paraqiti kërkesat e LDK-së që të bëhet hetim i pavarur dhe auditim i plotë i sistemit të faturimit të KESCO, dorëheqje

e Bordit të ZRrE-së, kompensim në mënyrë retroaktive për çdo qytetar të dëmtuar, ndërprerje të çdo procesi të shqyrtimit për rritje të tarifave të energjisë elektrike, hetim nga Prokuroria për përgjegjësi penale.

Azemi u bëri thirrje qytetarëve t'i kontrollojnë njehsorët nëpër shtëpitë e tyre si dhe të mos heshtin, duke kërkuar kompensim dhe llogari nga institucionet për këtë skemë mashtrimi.





KOSOVA PËRBALLË NJË PROVE POLITIKE: KOMPROMIS APO KRIZË E RE?

Kosova po shkon drejt zgjedhjeve të parakohshme për shkak të mungesës së konsensusit politik, vlerësojnë analistët. Mungesa e kulturës së kompromisit ndërpartiak rrezikon të krijojë një cikël të pafund krizash institucionale. Për pjesën më të madhe të vitit të kaluar, vendi ka funksionuar me qeveri në detyrë dhe Kuvend jofunksional si pasojë e mungesës së bashkëpunimit politik

PRISHTINË, 25 MARS - Kosova duket se po rrëshqet sërish drejt zgjedhjeve të parakohshme jo si rezultat i një domosdoshmërie demokratike, por si pasojë e një dështimi të vazhdueshëm politik për të ndërtuar konsensus dhe për t'i funksionalizuar institucionet. Edhe pse procesi mbetet teknikisht i pezulluar nga Gjykata Kushtetuese, sinjalet politike janë të qarta: vendi po hyn në një tjetër cikël zgjedhor që rrezikon të prodhojë të njëjtin rezultat - bllokadë. Analistët paralajmërojnë se, pavarësisht prej vendimit përfundimtar të Gjykatës Kushtetuese lidhur me dekretin e presidentes Vjosa Osmani për shpërndarjen e Kuvendit,

zgjedhjet e reja janë pothuajse të pashmangshme. “Të gjitha indikacionet tregojnë që, pas përfundimit të afateve kushtetuese, cilat do qofshin ato, Kosovën e pret një proces i ri zgjedhor”, thotë analisti Artan Muhaxhiri. Gjykata Kushtetuese e Kosovës ka vendosur masë të përkohshme deri më 31 mars, duke pezulluar efektet e dekretit të presidentes. Kjo nënkupton që deri atëherë nuk mund të shpallet data e zgjedhjeve të reja, por as të vazhdohet seanca për zgjedhjen e presidentit e nisur më 5 mars. Kërkesa për vlerësim të kushtetutshmërisë së dekretit të Osmanit u dorëzua nga Lëvizja Vetëvendosje e kryeministrit Albin

Kurti, me argumentin se procesi për zgjedhjen e presidentit ka një afat 60-ditor për t'u përmbyllur.

Një rrugë e trasuar drejt zgjedhjeve

Sipas Donika Eminit, nga Grupi Këshillues për Politikën e Ballkanit në Evropë - BiEPAG, edhe nëse Gjykata vendos në favor të interpretimit të afatit 60-ditor, realiteti politik mbetet i pandryshuar: mungesa e konsensusit e ka bërë zgjedhjen e presidentit pothuajse të pamundur. “Aktualisht nuk ka asnjë sinjal për konsensus ndërmjet partive politike për zgjedhjen e presidentit”, thekson ajo për Radion Evropa e Lirë. Mandati i Osmanit skadon në më pak se dy javë. Zgjedhja e presidentit në Kosovë bëhet nga Kuvendi dhe kërkon shumicë të kualifikuar votash - gjë që e bën procesin të varur nga kompromisi ndërpartiak. Në rast të dështimit, vendi shkon në zgjedhje. Disa parti politike po e trajtojnë tashmë skenarin e zgjedhjeve si të kryer. Kryeministri Albin Kurti shpreh

skepticizëm se zgjedhjet do të sjellin ndryshim real, duke paralajmëruar një “vazhdim të agonisë legislative dhe institucionale”. Në anën tjetër, opozita e sheh përgjegjësinë pikërisht te pushteti. Sipas kryetarit të Partisë Demokratike të Kosovës, Bedri Hamza, mungesa e vullnetit nga shumica parlamentare po e shtyn vendin drejt zgjedhjeve, në një kohë kur, sipas tij, “Kosova ka nevojë për stabilitet, përgjegjësi dhe zhvillim”. Gjatë një paraqitje në televizionin “Klan Kosova” ditë më parë, kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, tha se partitë politike kanë nisur “ngërçin e ri institucional”. “Në rrethanat e tanishme, të sigurta janë zgjedhjet e reja”, tha ai. Më pesimizëm ka shprehur Ardian Gjini i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, i cili ka paralajmëruar mundësinë e dy palë zgjedhjeve brenda vitit, nëse edhe pas zgjedhjeve të reja nuk arrihet marrëveshje për presidentin. “Ushtruesi i detyrës mund të qëndrojë vetëm gjashtë muaj, që nënkupton afatin deri më 5 tetor. Nëse deri atëherë nuk kemi as

president dhe as qeveri, vendi nuk do të ketë zgjidhje tjetër përveçse të shkojë në zgjedhje”, theksoi Gjini për mediet në Kosovë. Në këto rrethana, pyetja thelbësore që mbetet është: çfarë kuptimi kanë zgjedhjet?

Zgjedhje pa ndryshim?

Sipas Eminit, përvoja e viteve të fundit tregon se ciklet e përsëritura zgjedhore nuk kanë sjellë ndryshim substancial në funksionimin e skenës politike. Edhe zgjedhjet e fundit - të mbajtura më 28 dhjetor, rreth 10 muaj pas zgjedhjeve të 9 shkurtit 2025 - konfirmuan dominimin e Lëvizjes Vetëvendosje, pa garantuar një kapacitet real për konsensus institucional. “Zgjedhjet e reja ka shumë gjasë të japin rezultate të ngjashme me ato të mëparshmet. Mund të ketë vetëm lëvizje të vogla në përqindjen që mund të fitojnë partitë politike”, thotë ajo. Një faktor potencialisht i ri mund të jetë rikthimi i Vjosa Osmanit në skenën partiake, por edhe kjo, sipas Eminit, do të sillte një rikonfigurim të pjesshëm, e jo transformim thelbësor të skenës

OSMANI PËR FUSHATËN KUNDËR SAJ: KUR PROPAGANDA MUND TA KTHEJË KËDO NË TRADHTAR BRENDA NATËS, DEMOKRACIA ËSHTË NË RREZIK

EPOKA
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 25 MARS - Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, ka folur të mërkurën në konferencën “Java e Gruas”, organizuar nga Instituti Kombëtar Demokratik. Osmani në një paraqitje para të pranishmeve tha se “Java e Gruas” ka qenë ndër platformat e para që i ka dhënë zë. “Ka disa momente që nuk kërkojnë fjalë, të paktën jo shumë fjalë, por kërkojnë të vërtetën dhe ky është një prej tyre. Java e Gruas ka qenë ndër platformat e para që më ka dhënë zë, ndër vendet e para që më ka mundësuar të flas çdoherë kur zëri im tentohej të ndalej”, ka thënë ajo.

Presidentja Osmani këtë paraqitje e quajti të veçantë, pasi tha se është në fund të mandatit, kur disa gjëra bëhen më të qarta e disa marrin peshë më të madhe. E para e shtetit ka theksuar se gjatë këtyre viteve ka pasur privilegjin të takojë gra që nuk janë përkufizuar nga kufijtë që u janë vendosur, por nga horizontet që vetë ato i kanë hapur. “Kur gratë vendosin të ecin përpara për një shoqëri të tërë, historia dhe askush tjetër nuk ka më fuqi t’i mbajë peng... Pesë vjet më parë kur mora detyrën si presidente, nuk e pashë si kulm të rrugëtimit tim, por ishte një fillim, ishte ai moment kur filloi përgjegjësia më e lartë. Sepse kalimi nga përfaqësimi në përgjegjësi është një nga proceset më të vështira në politikë, sepse aty përfundon simbolika dhe fillon pesha reale e vendimeve. E në këtë kisha një detyrim të qartë, që pushteti të mos jetë privilegj, por vetëm shërbim”, është shprehur ajo.

Osmani më tutje ka theksuar se gjatë këtyre viteve vendi ka pasur përparim dhe se është dëshmuar se leadershipi me

integritet nuk është dobësi, po standard. “... Çdo përparim ka edhe një kundërpeshë. Koha e fundit e ka dëshmuar këtë. Në javët e fundit puna ime është përballur me një fushatë baltosëse që për qëllim nuk e ka kritikën dhe llogaridhënien. Është diçka tjetër, shumë më e ftohtë e krejtësisht e qëllimshme. Është përpjekje për ta zhveshur një njëri nga dinjiteti i tij njerëzor, për ta kthyer në objekt, për ta krahasuar me kafshët më të egra, për të zëvendësuar të vërtetën me imazhe të manipuluar”, ka thënë ajo. Sipas saj, këto imazhe krijohen për të lënduar dhe shkatërruar vlera njerëzore, gjersa shtoi se aq shumë përsëriten këto gënjeshtër sa dikujt mund t’i duken të vërteta. “Për këtë arsye duhet të flasim, por jo si viktimë, por si mbrojtëse të demokracisë”, ka deklaruar Osmani.

Ndër të tjera, Osmani ka thënë se kur propaganda e kthen këdo në tradhtar brenda natës, demokracia është në rrezik. “Kur propaganda mund ta kthejë këdo në tradhtar brenda natës, kur e vërteta më nuk ka asnjë rëndësi, kur dinjiteti shndërrohet në dëm kolateral, atëherë e tërë demokracia është rrezik”, është shprehur ajo.

Pos të tjerash, presidentja Osmani kërkoi përgjegjësi ndaj atyre që shfrytëzojnë teknologjinë për propagandë. “E një shoqëri që mësohet me një narrativë të tillë, e humb në tërësi busullën morale. Mirëpo kjo nuk është luftë ndaj një personi. Është mesazh i drejtpërdrejtë për secilën grua e vajzë që do të hyjë në jetën publike dhe politike”, u shpreh e para e vendit. Sipas saj, ky është një mesazh që thotë se për gratë në politikë ky është çmimi që duhet ta paguajnë. “Pikërisht për këtë arsye kjo s’është çështje personale, është



çështje e demokracisë. Sepse demokracia nuk rrëzohet vetëm nga krizat e mëdha,

dobësohet kur e vërteta goditet dhe bëhet e parëndësishme, kur shpifja bëhet mjete kryesor,

kur dinjiteti njerëzor trajtohet si pengesë e jo si vlerë”, ka thënë Osmani.

politike. Sipas saj, problemi nuk qëndron te vota, por te mungesa e kulturës së kompromisit. “Nëse situata vazhdon në këtë drejtim, hapësira ku qytetarët përfitojnë nga sistemi politik mbetet shumë e kufizuar. Kjo mbetet, ndoshta, pasoja më shqetësuese e gjithë krizës aktuale”, thotë Emini.

Rreziku i një cikli të pafund krizash

Të dy analistët paralajmërojnë se Kosova po hyn në një rreth vicioz, ku zgjedhjet nuk zgjidhin krizën, por e riciklojnë atë. Muhaxhiri vlerëson se në teori do të ishte logjike një rënie e mbështetjes për

Lëvizjen Vetëvendosje për shkak të mungesës së bashkëpunimit politik, por përvoja e fundit tregon të kundërtën. “Nuk pres ndryshim të madh. Kështu u mendua edhe vitin e kaluar, dhe ja ku jemi sot”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Sipas tij, ndryshimi i vetëm real do të vinte nga një reagim ndëshkues i elektoratit - një “votim transformues” që do t’i jepte fund “çoroditjes politike”. “Përndryshe, rrethi vicioz do të vazhdojë”, thotë ai.

Pasojat nuk janë vetëm të brendshme. Një krizë e vazhdueshme institucionale, paralajmëron Muhaxhiri, rrezikon ta largojë Kosovën edhe nga agjendat integruuese të Bashkimit

Evropian dhe t’i demotivojë aleatët ndërkombëtarë. “Zmbrapsja nga projektet evropiane e zvogëlon rëndësinë gjeopolitike të Kosovës dhe e nxjerr atë nga radari i bashkëpunimit”, thekson ai.

Çfarë do të duhej të bënin partitë politike?

“Në një skenar ideal, zgjedhjet e reja do të duhej të shmangeshin”, thotë Emini, duke theksuar se ende ekziston një dritare për kompromis, por vetëm nëse ka angazhim serioz për tejkalimin e ngërçit. E nëse vendi shkon në zgjedhje, ato do të kenë kuptim vetëm nëse shoqërohen me një

ndryshim të qasjes politike, sipas saj. “Partitë duhet të hyjnë në procesin zgjedhor me një qëllim të qartë: të punojnë për interesin afatgjatë të vendit, jo për dominim politik apo përfitime të ngushta. Kjo nënkupton gatishmëri për dialog, negociata mbi baza programore dhe fokus në nevojat reale të qytetarëve”, thotë Emini. Skepticizëm ka shprehur edhe analisti Artan Muhaxhiri, i cili nuk pret ndryshim të qasjes nga Lëvizja Vetëvendosje, por as një alternativë të qartë nga opozita. Sipas tij, as PDK-ja, LDK-ja dhe AAK-ja nuk kanë dëshmuar deri më tani se kanë një strategji bindëse për ta sfiduar dominimin politik të Vetëvendosjes. “Nëse

partitë opozitare arrijnë ta rrisin mbështetjen dhe të sigurojnë shumicën prej 61 deputetësh, atëherë përgjegjësia minimale politike do të ishte harmonizimi i qëndrimeve dhe bashkëqeverisja në përputhje me fuqinë elektorale”, thekson Muhaxhiri, ndonëse nuk beson se një skenar i tillë është i arritshëm. Sipas tij, ndalja e ciklit të krizave të njëpasnjëshme institucionale mbetet alternativa e vetme racionale - dhe një detyrim i drejtpërdrejtë për klasën politike. “Në të kundërtën, çdo opsion tjetër përbën investim në gërryerjen e shtetit dhe përshpejtim të rrugës drejt pashtetësisë”, përfundon ai.

MBAHET PUNËTORIA PËR HARTIMIN E LEGJISLACIONIT NË KUADËR TË REFORMAVE NË DREJTËSI

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 MARS - Zëvendëskryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, Dardan Vuniqi, kryetari i Komisionit për Çështje Normative të KPK-së, Visar Krasniqi dhe kryeprokurori i Prokurorisë Themelore në Prizren, Petrit Kryeziu, kanë marrë pjesë në punëtorinë treditore të organizuar nga Ministria e Drejtësisë e cila ka për qëllim hartimin dhe finalizimin e legjislacionit që buron nga Deklarata e Përbashkët e Zotimit në kuadër të

konsolidimit të reformave në sistemin e drejtësisë. Gjatë diskutimeve është theksuar se ky proces përfaqëson një hap thelbësor drejt operacionalizimit të angazhimeve të ndërmarra dhe avancimit të kornizës ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe opinionet relevante të Komisionit të Venecias. Në kuadër të punëtorisë, draftet ligjore janë duke u shqyrtuar në mënyrë gjithëpërfshirëse, me fokus në ofrimin e kontributit profesional dhe rekomandimeve konkrete për përmirësimin e tyre, me synim



rritjen e efikasitetit, pavarësisë dhe transparencës së sistemit të drejtësisë, me ç'rast

bashkëpunimi ndërinstitucional dhe integrimi i ekspertizës vendore dhe

ndërkombëtare janë vlerësuar si faktorë esenciale për sigurimin e reformave të qëndrueshme dhe të zbatueshme në praktikë. Përfaqësuesit e sistemit prokurorial kanë konfirmuar përkushtimin e tyre për të qenë pjesë aktive e proceseve reformuese, duke kontribuar në forcimin e sundimit të ligjit dhe rritjen e besimit të publikut në institucionet e drejtësisë. Ata do ta vazhdojnë angazhimin konstruktiv në të gjitha fazat e këtij procesi, në funksion të hartimit të legjislacionit cilësor që garanton funksionim të drejtë, efikas dhe në shërbim të qytetarëve.

BUXHETI I KOSOVËS DUHET T'U DALË NDESH NEVOJAVE TË NDRYSHME TË GRAVE DHE BURRAVE

EPOKA E RE Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 25 MARS - Një koalicion i përbërë nga dhjetë organizata të shoqërisë civile i kanë dërguar të mërkurën Qeverisë së Kosovës një deklaratë të përbashkët publike, duke kërkuar që buxheti i vitit 2026 dhe korniza e ardhshme afatmesme e shpenzimeve të adresojnë në mënyrë aktive nevojat e të gjithë qytetarëve dhe pengesat që kufizojnë pjesëmarrjen e grave në tregun e punës. Ky koalicion i organizatave të shoqërisë civile i bën thirrje qeverisë qendrore dhe udhëheqjes komunale që të sigurojnë se çdo rishikim i ardhshëm i buxhetit për vitin 2026 dhe korniza e ardhshme afatmesme e shpenzimeve i përmbushin nevojat e ndryshme të të gjithë qytetarëve. Hulumtimet e fundit nga Rrjeti i Grave të Kosovës (RrGK) dhe Caritasi Zvicëran në Kosovë konfirmojnë se barrierat strukturore aktualisht i lënë 74 % të grave jashtë tregut të punës. Ndërkohë që pjesëmarrja e burrave në fuqinë punëtore është rreth 60 %, pjesëmarrja e grave qëndron vetëm në 26 %. Ky përjashtim krijon një mungesë të vetë-imponuar të fuqisë punëtore që pengon prosperitetin ekonomik të

Kosovës. “U bëjmë thirrje institucioneve udhëheqëse të kalojnë nga fjalët në vepra, përtej “zotimeve në letër”, dhe të investojnë në gjashtë fusha kritike”, thuhet në këtë adresim.

1. Një ligj të ri për punën

Ligji aktual, i cili është në rishikim prej më shumë se tetë vitesh, kontribuon në diskriminimin ndaj grave në punësim. Bëjmë thirrje për një ligj të ri për punën, të përafëruar me Direktivën e BE-së për balancën punë-jetë, i cili siguron që shteti, dhe jo punëdhënësi, të mbulojë pagesën e pushimit të lehonisë, atësisë dhe lejes prindërore, si dhe t'u ofrojë burrave më shumë të drejta për pushim.

2. Investime në shërbimet e kujdesit

Mungesa e shërbimeve të përbalueshme dhe të qasshme për kujdesin ndaj fëmijëve mbetet një nga barrierat kryesore për punësimin e grave. Në komuna si Drenasi, Malisheva dhe Kamenica, këto shërbime janë tejte të kufizuara. Investimi në një rrjet kombëtar të kujdesit dhe lehtësimit të pagesave të kopshteve për edukim të fëmijëve mund të

krijojë 10 000 vende formale pune, duke u mundësuar mijëra grave të hyjnë në tregun e punës.

3. Sigurimi i transportit të qasshëm në vendet rurale

Transporti publik jo i besueshëm izolon gratë në zonat rurale, të cilat kanë më pak gjasa të zotërojnë vetura dhe mbështeten më shumë në transportin publik. U bëjmë thirrje komunave të rishikojnë transportin publik në zonat rurale dhe të ofrojnë subvencione për linjat e transportit për punëtorët, në mënyrë që gratë (dhe burrat) në zonat rurale të kenë qasje të sigurt dhe të përbalueshme në tregjet urbane të punës.

4. Institucionalizimi i buxhetimit të përgjegjshëm gjinor

Megjithëse qeveria është zotuar për buxhetim të përgjegjshëm gjinor (BPGj), zbatimi i tij është vonuar. Shumat aktuale të alokuara për fuqizimin ekonomik të grave rrallë tejkalojnë 10 000€ në vit. Ne i bëjmë thirrje qeverisë që të institucionalizojë BPGj-në duke ndryshuar Ligjin për Financa



Publike dhe Ligjin për Prokurime Publike, ndër të tjera, si dhe të përgatisë dhe të publikojë rregullisht shtojcat e BPGj-së që kërkojnë nga qarkoret buxhetore. Gjithashtu, Zyrtarëve për Barazi Gjinore (ZBGj) duhet t'u jepen burime të mjaftueshme për mandatet e tyre si dhe role programatike në planifikimin e buxheteve për sektorë si bujqësia, transporti dhe zhvillimi ekonomik.

5. Sigurimi i llogaridhënies në agjendën e reformave

Buxhetit kombëtar rekord prej 4 miliardë€ dhe Plani i Rritjes i BE-së prej 880 milionë € duhet të përdoren që vërtetë të nxisin barazinë. Qeveria duhet të

miratojë tregues të qartë gjinorë lidhur me ndikimin e saj si dhe të angazhohet në konsultime publike transparente me organizatat për të drejtat e grave, në mënyrë që të mbështesë sa më mirë zbatimin e tyre. “Ne mbesim të gatshëm të bashkëpunojmë me autoritetet qendrore dhe komunale për të përmirësuar ligjet dhe politikat relevante, si dhe për të mbështetur forcimin e kapaciteteve për buxhetim të përgjegjshëm gjinor në institucionet që nxisin zhvillim ekonomik gjithëpërfshirës. Le të punojmë së bashku, politikëbërës dhe shoqëri civile, për të sjellë zgjidhje dhe mundësi zhvillimi ekonomik për gratë dhe burrat e Kosovës”, është thënë në thirrjen e këtyre organizatave joqeveritare.

Rreth 500 raste të reja me kancer në QKUK ende pa u mbyllur tremujori

PRISHTINË, 25 MARS - Klinika e Onkologjisë informon publikun se trendi i paraqitjes së sëmundjeve malinje në Kosovë mbetet relativisht i qëndrueshëm gjatë viteve të fundit. Në bazë vjetore regjistrohen mesatarisht rreth 2 100 raste të reja, që përkthehet në një numër të menaxhueshëm rastesh në

bazë mujore. Gjatë periudhës janar - 20 mars të këtij viti në Klinikën e Onkologjisë janë pranuar dhe trajtuar për herë të parë rreth 500 pacientë të cilët kanë kaluar nëpër proceset e nevojshme të ekzaminimit, diagnostikimit dhe trajtimit sipas standardeve bashkëkohore mjekësore. “Këto të dhëna tregojnë një situatë të

qëndrueshme dhe të monitoruar me kujdes nga profesionistët shëndetësorë, ndërkohë që incidenca e sëmundjeve malinje në vend vazhdon të mbetet më e ulët krahasuar me disa vende të rajonit. Klinika e Onkologjisë punon vazhdimisht për avancimin e shërbimeve për pacientët, duke u fokusuar në

diagnostikimin e hershëm, ofrimin e trajtimeve moderne dhe sigurimin e kujdesit të vazhdueshëm dhe cilësor për çdo pacient. Klinika edhe më tej do të punojë në ngritjen e kapaciteteve profesionale dhe teknologjike, si dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për rëndësinë e kontrolleve të rregullta, me qëllim përmirësimin e shëndetit



publik dhe mirëqenies së qytetarëve”, ka njoftuar Shërbimi Spitalor Klinik dhe Universitar i Kosovës.

12 AERODROMET E BRAKTISURA TË KOSOVËS

Dymbëdhjetë fusha ajrore në Kosovë janë braktisur ose privatizuar, megjithëse mund ta zhvillonin aviacionin e përgjithshëm. Këto hapësira, të ndërtuara dikur për tokat bujqësore, sot janë të papërdorura ose shfrytëzohen vetëm për trajnime lokale. Ekspertët thonë se humbja e këtyre aerodromeve ishte gabim strategjik, ndërsa qeveria nuk tregon nëse ka plan për rifunksionalizimin e tyre

PRISHTINË, 25 MARS - Kosova, me 1.5 milion banorë, ka vetëm një aeroport ndërkombëtar të certifikuar që e lidh me botën: Aeroportin “Adem Jashari” në Prishtinë. Pak e dinë se brenda territorit të saj fshihen edhe 12 fusha apo pista ajrore të regjistruara si kategori e veçantë e aerodromeve në komuna të ndryshme. Këto hapësira janë ndërtuar kryesisht mbi toka bujqësore dhe shtrihen në komunat: Drenas, Skenderaj, Rahovec, Malishevë, Prizren, Suharekë, Ferizaj, Gjilan, Istog, Podujevë dhe dy në Klinë. Ato nuk janë aeroporte komerciale dhe zakonisht nuk pranojnë fluturime komerciale. Edhe pse para luftës së viteve 1998/1999 kishin funksion të qartë bujqësor, si spërkatje e tokave, sot gjendja e tyre është krejt ndryshe: disa janë mbuluar nga mbeturinat, disa janë privatizuar e disa përdoren nga autoshollat. Karakteristikë e përbashkët e tyre është madhësia e pistës - zakonisht 450 metra gjatësi dhe 18 metra gjerësi. Një dokument i publikuar nga Autoriteti i Aviacionit Civil të Kosovës (AAC) në vitin 2015 konfirmon ekzistencën e këtyre fushave, por thekson se ato nuk kanë status formal regjistrimi apo autorizimi për operime ajrore, duke shërbyer vetëm për ta pasqyruar gjendjen e tyre infrastrukturore.

Historiku i fushave ajrore

Fusha ajrore është një zonë e caktuar mbi tokë, e cila përdoret plotësisht apo pjesërisht për aterrim, nisje dhe lëvizje të mjeteve ajrore. Në Kosovë këto fusha apo pista u ndërtuan në vitet '70 dhe '80 nga ish-ndërmarrja shoqërore “Agro-Kosova” për spërkatjen e tokave bujqësore. Shtrirja e tyre ishte planifikuar për t'i mbuluar të gjitha rajonet e vendit. Megjithatë, gjatë viteve '90, kur edhe nisën masat e dhunshme të regjimit të atëhershëm serb, aviacioni i përgjithshëm ndaloi zhvillimin në Kosovë, duke sjellë edhe degradimin gradual të këtyre hapësirave. Pas përfundimit të luftës më 1999, administrimi i këtyre hapësirave kaloi fillimisht tek Agjencia e atëhershme Kosovare e Mirëbesimit (AKM), e më pas tek Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Me ligj, AKP-ja është e autorizuar për administrim, shitje dhe transferim të ndërmarrjeve

shoqërore. Por, ajo nuk iu përgjigj pyetjeve të Radios Evropa e Lirë për numrin e fushave ajrore të privatizuara apo mënyrën e trajtimit të tyre.

Kush i menaxhon aerodromet?

Autoriteti i Aviacionit Civil (AAC) është institucioni përgjegjës për certifikimin, aprovimin dhe regjistrimin e aerodromeve për shfrytëzim civil. Aerodromet kategorizohen si të certifikuara, të aprovuara dhe të regjistruara, në varësi të natyrës së operimeve dhe shkallës së shfrytëzimit. Arianit Islami, ushtrues i detyrës së drejtorit të përgjithshëm të AAC-së, thotë për Radion Evropa e Lirë se përdorimi dhe zhvillimi i këtyre hapësirave nuk është në kompetencë të drejtpërdrejtë të këtij institucioni, por se varet nga pronarët e tyre dhe operatorët potencialë. “Roli i AAC-së është që, në rast të iniciativave për funksionalizimin e tyre për qëllime aeronautike, të sigurojë që çdo zhvillim dhe operim të jetë në përputhje me kërkesat rregullatore dhe standardet e sigurisë në fuqi”, thotë Islami. Aktualisht, sipas tij, asnjë nga fushat ajrore të identifikuara nuk ka status të regjistruar, të aprovuar apo të certifikuar, prandaj nuk konsiderohen funksionale për operime ajrore civile. Megjithatë, thekson se disa prej këtyre hapësirave mund të përdoren për aktivitete ajrore, pas vlerësimit nga inspektorët e institucionit dhe përbushjes së kërkesave përkatëse rregullatore.

Gjendja e fushave ajrore komunë për komunë

Malishevë

Deri më tani vetëm aerodromi i Malishevës është shfrytëzuar herë pas here për operime ajrore pas përbushjes së kërkesave të përcaktuara nga AAC-ja. Më 14 qershor 2024 ky institucion regjistroi fushën e parë ajrore që gjendet në fshatin Banjë të kësaj komune. Një ditë më pas, më 15 qershor, AAC-ja njoftoi në faqen e saj zyrtare se në këtë hapësirë janë realizuar fluturimet e para, me dy aeroplanë të huazuar dhe me përkrahjen e Aeroklubit Shkupi nga Maqedonia e Veriut. Sipas AAC-së, ky aktivitet kishte për qëllim promovimin e aviacionit të përgjithshëm dhe



rritjen e ndërgjegjësimit për funksionalizimin e fushave ajrore në Kosovë, si hapësira që mund të shfrytëzohen nga pilotët dhe entuziastët e aviacionit.

Drenas

Fusha ajrore në fshatin Korroticë, në komunën e Drenasit, ndodhet rreth 25 kilometra nga Prishtina dhe vetëm 10 kilometra vijë ajrore nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari”. Megjithatë, kjo pistë sot është pothuajse tërësisht e mbuluar me mbeturina dhe gurë të mëdhenj, duke e bërë të papërdorshme. Gjendja e saj konfirmohet edhe nga Zyra për Informim e Komunës së Drenasit. “Fusha është nën përgjegjësinë e Agjencisë Kosovare të Privatizimit (AKP) dhe aktualisht nuk shfrytëzohet për ndonjë aktivitet specifik”, thuhet në përgjigjen e komunës për Radion Evropa e Lirë.

Podujevë

Fusha ajrore në Dumosh të Podujevës është marrë në administrim nga institucionet qendrore të Kosovës, përkatësisht nga Ministria e Mbrojtjes dhe Forca e Sigurisë së Kosovës, për përdorim në funksione që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen. Kështu bëri me dije për Radion Evropa e Lirë Zyra për Informim e komunës së Podujevës. E, Ministria e Mbrojtjes nuk i dha sqarime REL-it lidhur me mënyrën konkrete të shfrytëzimit të kësaj hapësire apo institucionin që e përdor atë.

Suharekë

Pas përfundimit të luftës, në aerodromin e Suharekës u vendosën trupat e misionit paqeruajtës të NATO-s, KFOR. Pas largimit të tyre, disa vite më vonë, prona kaloi nën administrimin e Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe më pas u privatizua. “Aktualisht është pronë private dhe, sipas hartave zonale komunale, është e përcaktuar si zonë komerciale”, konfirmon Arta Gashi, nënkryetare e Komunës së Suharekës, për Radion Evropa e Lirë.

Skenderaj

Fusha ajrore në Skenderaj ndodhet 40 km larg qytetit të Prishtinës dhe vetëm 20 km vijë ajrore nga Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem

Jashari”. Ndryshe nga fushat e tjera, zyrtarët e kësaj komune bëjnë të ditur se parcela është e regjistruar dhe pronë e Komunës së Skenderajt. “Parcela ka sipërfaqe mbi 350 metra katrorë. Në bazë të evidencës zyrtare nuk ka ndonjë objekt të regjistruar apo bazë të funksionimit të fushës ajrore, edhe pse në gjendjen reale është e ndërtuar”, thotë Besjana Thaçi, zyrtare për informim në komunë, për Radion Evropa e Lirë. Sipas dokumentit të AAC-së nga viti 2015, kjo fushë ajrore “mund të bëhet funksionale me një investim minimal”. Hapësira është shumë e përshtatshme për aktivitete të aviacionit të përgjithshëm dhe në disa raste përdoret nga auto-shkollat lokale për trajnim të vozitësve fillestarë, thuhet në dokument.

Klinë

Në territorin e komunës së Klinës ekzistojnë dy hapësira të identifikuara si fusha ajrore: njëra në fshatin Jashanicë dhe tjetra në Krushevë. Nikson Daka, drejtor i Kadastrës, Gjeodezisë dhe Pronësisë në këtë komunë, thotë për Radion Evropa e Lirë se këto hapësira nuk janë në funksion të rregullt për operime ajrore civile apo komerciale dhe janë jashtë përdorimit aktiv. “Të dyja këto hapësira kanë kaluar në menaxhim të AKP-së; njëra është privatizuar, ndërsa tjetra vazhdon të mbahet nën administrimin e kësaj agjencie”, thotë ai, duke shtuar se ato kanë nevojë për investime në infrastrukturë, mirëmbajtje dhe standarde sigurie.

Rahovec

Fusha ajrore në Rahovec ishte në pronësi të kompanisë NBI-Rahoveci, e cila më pas u privatizua. Zyrtarë të komunës thanë për REL-in se “në periudhën e NBI-Rahovecit, kjo fushë shërbente si pistë për avionët bujqësorë dhe përdorej për spërkatjen e vreshtave. Pas privatizimit, ajo mbeti jashtë funksionit”.

Prizren

Në territorin e komunës së Prizrenit ka ekzistuar një ngastër kadastrale e destinuar si fushë ajrore për nevoja bujqësore të ndërmarrjes Progresi. Komuna nuk ka asnjë kompetencë ligjore apo administrative mbi këtë tokë. “Pas

vitit 1999, tokat e Progresit kaluan në menaxhim të AKM-së, pastaj të AKP-së, dhe nuk kemi informata se çfarë ka ndodhur me këtë pronë bujqësore”, thonë nga Komuna e Prizrenit për Radion Evropa e Lirë. Sipas dokumentit të AAC-së, fusha ajrore në këtë komunë është privatizuar dhe ndarë nëpër parcela të ndryshme - çka e bën identifikimin e saj praktikisht të pamundur.

Gjilan, Istog, Ferizaj

Radio Evropa e Lirë nuk mori përgjigje nga zyrtarët e komunave të Gjilanit dhe Istogut për gjendjen e aerodromeve, ndërsa Komuna e Ferizajt konfirmoi se “nuk ka në menaxhim ndonjë hapësirë të tillë”. Sipas AAC-së, vetëm 5 nga 12 fushat ajrore ishin në gjendje të mirë fizike dhe infrastrukturore një dekadë më parë.

Privatizimi i pistave ajrore - gabim strategjik

Ekspertët e aviacionit e konsiderojnë degradimin dhe privatizimin e këtyre hapësirave si gabim strategjik. Eset Berisha, ish-drejtor i Autoritetit të Aviacionit Civil të Kosovës, thotë se përmes një strategjie të qartë të aviacionit civil, disa pista nuk duhej të shiteshin, pasi ato mund të shfrytëzoheshin për qëllime të aviacionit dhe nevoja të tjera publike. “Këto hapësira mund të shfrytëzoheshin, për shembull, për shkollimin e pilotëve dhe zhvillimin e kuadrove të reja në aviacion. Por, nëse është ndryshuar destinimi, shteti ka humbur kontrollin dhe mundësinë për t'i përdorur për këto qëllime”, thotë ai për Radion Evropa e Lirë. Ngjashëm vlerëson edhe Afrim Aziri, ish-drejtor në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, i cili thekson se mungesa e planifikimit afatgjatë, ka rezultuar me humbjen e potencialit të këtyre hapësirave për zhvillimin e aviacionit. “Këto hapësira mund të shfrytëzoheshin për fluturime akrobatike dhe sportive, për hapjen e shkollave të fluturimit, ku kostoja e trajnimit të pilotëve të rinj do të ishte më e ulët, si dhe për trajnim dhe shkollim profesional për pilotimin e dronëve”, thotë Aziri për Radion Evropa e Lirë. Islami i AAC-së thekson se zhvillimi i infrastrukturës së aviacionit civil, përfshirë aerodromet e vogla, është pjesë e politikave qeveritare dhe planifikimit institucional, e jo kompetencë e drejtpërdrejtë e AAC-së. Sipas tij, AAC-ja mbështet zhvillimin e aviacionit civil, përfshirë atë sportiv, për sa kohë respektohet korniza ligjore në fuqi. Qeveria e Kosovës nuk iu përgjigj interesimit të REL-it nëse ka ndonjë strategji për aviacionin dhe cilat janë planet për të ardhmen e këtyre aerodromeve.

AKB-ja ngre alarmin për një nga kërcënimet më të mëdha ndaj ekonomisë dhe sigurisë globale

PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Aleancës Kosovare të Bizneseve (AKB), Agim Shahini, ka ngritur shqetësimin për një nga kërcënimet më serioze ndaj ekonomisë dhe sigurisë globale. Ai ka thënë se nëse bllokohet Ngushtica e Hormuzit, Lindja e Mesme mund të mbetet pa ushqim dhe bota pa energji. “80 % e ushqimit për Lindjen e Mesme dhe rreth 20% e energjisë globale varen nga një korridor i vetëm strategjik. Aleanca Kosovare e Bizneseve (AKB) ngre shqetësim për një nga

kërcënimet më serioze ndaj ekonomisë dhe sigurisë globale. Sipas analizës së AKB-së: Mbi 80 % e ushqimit për vendet e Lindjes së Mesme kalon përmes kësaj rruge. Mbi 50 % e ujit të pijshëm sigurohet nga desalinizimi. Rreth 20 % e energjisë globale transportohet përmes këtij korridori jetik. Një ndërprerje në këtë arterie nuk është thjesht krizë rajonale. Është tronditje globale. Pasojat do të ishin të menjëhershme, mungesë ushqimi dhe ujë i pijshëm në Lindjen e Mesme,

rritje drastike e çmimeve të energjisë dhe destabilizim i tregjeve ndërkombëtare”, ka thënë Shahini. Ai ka theksuar se sot një pikë e vetme gjeografike mban në ekuilibër jetën ekonomike të miliona njerëzve. “AKB-ja u bënë thirrje institucioneve t’i diversifikojnë rrugët e furnizimit, t’i rrisin rezervat strategjike, ta forcojnë sigurinë ushqimore dhe energjetike. Çdo përshkallëzim në këtë zonë mund të ketë pasoja të paparashikueshme për ekonominë botërore”, thotë Agim Shahini, kryetar i AKB-së.



EKONOMIA BOTËRORE NË PIKËN E THYERJES: KRIZA ENERGJETIKE QË PO RIKONSTRUKTON RENDIN GLOBAL



Shkruan:
Nazmi JUSUFI

Ekonomia botërore po hyn në një fazë të re të pasigurisë strukturore, ku rritja e çmimit të naftës nuk është më një luhatie e zakonshme e tregut, por një sinjal i qartë i një transformimi të thellë gjeoekonomik. Në këtë moment, çmimi i energjisë është bërë barometri më i saktë i tensioneve globale, duke reflektuar jo vetëm mungesën e furnizimit, por edhe fragmentimin e arkitekturës ndërkombëtare të sigurisë energjetike. Kjo situatë po krijon një presion të

shumëfishtë mbi ekonominë botërore, duke e çuar atë drejt një krize të re që nuk ngjan me asnjë nga ciklet e mëparshme. Rritja e çmimit të naftës po transmetohet në mënyrë të menjëhershme në të gjitha segmentet e ekonomisë reale. Kostoja e prodhimit është rritur në mënyrë të ndjeshme, duke prekur sektorët që varen nga transporti, kimikatet, bujqësia dhe industria e rëndë. Në një ekonomi të globalizuar, ku zinxhirët e furnizimit janë të ndërlidhur dhe të varur nga efikasiteti logjistik, çdo rritje e çmimit të energjisë krijon një efekt domino që përshpejton inflacionin dhe ul kapacitetin e konsumatorëve për të përballuar shpenzimet bazë. Kjo situatë po e shtyn shumë vende drejt një kombinimi të rrezikshëm të inflacionit të lartë dhe rritjes së ulët ekonomike, një skenar që historikisht ka rezultuar në kriza të thella financiare.

Në nivel makroekonomik,

tregjet financiare po reagojnë me volatilitet të shtuar, duke reflektuar frikën se rritja e çmimit të energjisë mund të shndërrohet në një krizë të likuiditetit për sektorët më të ekspozuar. Bankat qendrore, të cilat tashmë përballen me presionin e inflacionit, gjenden në një pozitë të vështirë: rritja e normave të interesit mund të frenojë kërkesën, por rrezikon të ngadalësojë më tej ekonominë; ndërsa mbajtja e normave të ulëta mund të përshpejtojë inflacionin dhe të dëmtojë stabilitetin financiar. Ky është një ekuacion i paqëndrueshëm, i cili tregon se instrumentet tradicionale të politikës monetare nuk janë më të mjaftueshme për të menaxhuar një krizë që ka origjinë strukturore dhe gjeopolitike. Nga ana tjetër, zinxhirët globalë të furnizimit po përballen me ndërprerje të vazhdueshme, të cilat nuk lidhen vetëm me çmimin e energjisë, por edhe me rritjen e pasigurisë në pikat

strategjike të transportit ndërkombëtar. Këto ndërprerje po krijojnë vonesa, mungesa të mallrave dhe rritje të kostove operative, duke e bërë të pamundur që tregjet të rikthehen në normalitet në afat të shkurtër. Në këtë kontekst, ekonomitë e vogla dhe të mesme janë më të ekspozuara, pasi varen nga importet dhe nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për të absorbuar goditjet e njëpasnjëshme të tregut. Në planin politik, kriza energjetike po nxit një rishikim të strategjive kombëtare të sigurisë ekonomike. Vendet po përpiqen të diversifikojnë burimet e furnizimit, të rrisin rezervat strategjike dhe të investojnë në energji alternative, por këto masa kërkojnë kohë dhe nuk ofrojnë zgjidhje të menjëhershme. Në të njëjtën kohë, konkurrenca për burimet energjetike po intensifikohet, duke krijuar një terren të ri rivalitetesh ekonomike dhe gjeopolitike. Kjo

situatë rrezikon të thellojë fragmentimin global dhe të dobësojë mekanizmat e bashkëpunimit ndërkombëtar, të cilët historikisht kanë qenë thelbësorë për stabilitetin ekonomik. Nëse kjo dinamikë vazhdon, bota mund të hyjë në një periudhë të re të ristrukturimit ekonomik, ku energjia do të jetë faktori përcaktues i fuqisë ekonomike dhe i stabilitetit politik. Kriza aktuale nuk është thjesht një problem çmimesh, por një provë e qëndrueshmërisë së sistemit global, i cili po përballlet me sfida të njëkohshme: tensione gjeopolitike, mungesë koordinimi ndërkombëtar, dobësi strukturore dhe varësi të thellë nga burimet fosile. Në këtë realitet të ri, vendimarrja ekonomike kërkon qasje më të thella analitike, strategji afatgjata dhe një kuptim të qartë të rreziqeve që po formësojnë të ardhmen e ekonomisë botërore.

BQK dhe BB, diskutojnë për hapat e ardhshëm në reformat e sektorit financiar

PRISHTINË, 25 MARS - Guvernatori i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK), Ahmet Ismaili, i shoqëruar nga zëvendës guvernatorët Shileku Shala dhe Fusha, priti në takim delegacionin e nivelit të lartë të Grupit të Bankës Botërore. Takimi u përqendrua në shqyrtimin e përparimit dhe përcaktimin e hapave të ardhshëm për zbatimin e reformave kyçe në sektorin financiar të Kosovës. Guvernatori Ismaili paraqiti zhvillimet e fundit në sektorin financiar, veçanërisht në mbikëqyrjen bankare dhe të

sigurimeve, duke theksuar qëndrueshmërinë dhe stabilitetin e vazhdueshëm të sektorit. Diskutimet u përqendruan në zbatimin e Projektit për Zhvillimin e Sektorit Financiar, përfshirë përparimin drejt krijimit të Sistemit të Pagesave të Shpejta bazuar në TIPS Clone të ofruar nga Banca d'Italia. U theksua gjithashtu përparimi në kuadër të Projektit për Shërbimet Digjitale Financiare, përfshirë krijimin e strukturave koordinuese, avancimin e Open Banking përmes një grupi të posaçëm pune, përmirësimin e

Regjistrin të Kredive, si dhe avancimin e proceseve digjitale të identifikimit të klientëve. Xiaoqing Yu dhe Marcelo Castellanos rikonfirmuan angazhimin e fortë të Grupit të Bankës Botërore për ta mbështetur agjendën e reformave të BQK-së. BQK-ja ka shprehur mirënjohjen për partneritetin e vazhdueshëm me Grupin e Bankës Botërore dhe mbetet e përkushtuar për avancimin e reformave që forcojnë stabilitetin financiar, modernizojnë sektorin financiar dhe rrisin gjithëpërfshirjen financiare në Kosovë.



FJALË VLERËSIMI NË PËRVJETORIN E BETEJËS SË GLLOGJANIT MË 24 MARS 1998 DHE FITORES SË UÇK-së
MBAJTUR NË GLLOGJAN MË 24 MARS 2026

24 MARS 1998 DHE OPERACIONI LUFTARAK I ARMIKUT NË GLLOGJAN

(Gllogjani i UÇK-së përballë forcës ushtarake e policore serbe e jugosllave)



Kudusi LAMA

Të nderuar familjarë të dëshmorëve,
Të nderuar luftëtarë të lirisë,
Të nderuar bashkëluftëtarë dhe veteranë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,
Të nderuar përfaqësues të institucioneve të Republikës së Kosovës,
Të nderuar personalitete të jetës publike, akademike dhe shoqërore,
Të dashur pjesëmarrës,
Sot jemi mbledhur në këtë tubim përkujtimor me ndjenjë të thellë respekti, mirënjohjeje dhe përgjegjësie historike për të kujtuar një nga momentet më domethënëse të luftës sonë çlirimtare, një nga çastet më të rëndësishme të historisë së rezistencës së armatosur shqiptare në Kosovë - përballjen e lavdishme në Gllogjan, më 24 mars 1998. Një përballje që nuk ishte thjesht një betejë ushtarake, por një provë e madhe e karakterit, e guximit dhe e vendosmërisë së popullit shqiptar për liri. Një ngjarje që shënoi një kthesë të

rëndësishme në rrjedhën e luftës çlirimtare. Kujtojmë sot një betejë që në historinë e Luftës Çlirimtare të Kosovës zë një vend të veçantë. Kujtojmë një moment kur përballë një makinerie të fuqishme ushtarake qëndroi një grusht luftëtarësh të vendosur, të cilët nuk kishin as epërsi numerike, as epërsi në armatim, por kishin diçka shumë më të madhe: besimin në drejtësinë e kauzës së tyre dhe vendosmërinë për të mos u nënshtruar kurrë. Kjo nuk është vetëm një ditë kujtimi. Kjo është një ditë reflektimi për historinë tonë, për sakrificën e një brezi të tërë dhe për rrugën që populli shqiptar përshkoi për ta arritur lirinë. Gllogjani nuk është thjesht një vend në hartën e Kosovës. Ai është një simbol. Një simbol i qëndresës shqiptare. Një simbol i guximit përballë një force shumë më të madhe ushtarake. Një simbol i besimit të palëkundur se liria është një

e drejtë që duhet mbrojtur me çdo çmim. Në historinë e kombeve, ka momente që e ndryshojnë rrjedhën e zhvillimeve. Momente kur vendosmëria e një grupi njerëzish bëhet frymëzim për një popull të tërë. Beteja e Gllogjanit ishte një nga ato momente. Ajo dëshmoi se lufta për liri nuk matet vetëm me numra, me armë apo me teknologji ushtarake. Ajo matet me shpirtin e atyre që luftojnë. Ajo matet me besimin se drejtësia historike është në anën e tyre. Historia e popullit shqiptar është histori qëndrese, sakrifice dhe përpjekjeje të vazhdueshme për liri. Në këtë histori të gjatë dhe të vështirë, Kosova ka qenë shpeshherë në qendër të përballjeve më të mëdha. Në ato përballje janë provuar karakteri, guximi dhe vendosmëria e shqiptarëve për të mos u nënshtruar kurrë. Në pranverën e vitit 1998, pas goditjes së rëndë që forcat serbe ndërmorën në Prekaz

kundër familjes heroike të komandantit legjendar Adem Jashari, Serbia mendoi se kishte arritur të thyejë shpirtin e rezistencës shqiptare. Ajo besoi se me atë goditje do të mbillte frikë dhe dorëzim në zemrat e shqiptarëve. Por historia dëshmoi të kundërtën. Lufta deri në sakrificë e familjes Jashari nuk e dobësoi luftën për liri, përkundrazi e forcoi atë. Ajo u bë një thirrje për qëndresë dhe një burim frymëzimi për gjithë shqiptarët. Në vend të dorëzimit, në gjithë Kosovën u përhap një vendosmëri e re për të vazhduar luftën deri në çlirimin përfundimtar. Në këtë klimë vendosmërie dhe mobilizimi, Dukagjini u shndërrua në një nga qendrat më të rëndësishme të organizimit të rezistencës. Në këtë trevë, luftëtarët e lirisë nuk qëndruan duarkryq. Sulmet ndaj forcave serbe u bënë të vazhdueshme dhe të guximshme. Në çdo vend, në çdo kohë -

ditën dhe natën - forcat e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës godisnin armikun dhe tregonin se rezistenca shqiptare ishte gjallë dhe e vendosur. Pikërisht kjo gjendje e re në terren e shqetësoi shumë udhëheqjen ushtarake dhe policore serbe. Ata e kuptuan se rezistenca nuk ishte shuar dhe se lufta çlirimtare po merrte përmasa gjithnjë e më të mëdha. Për këtë arsye, armiku vendosi të ndërmarrë një tjetër operacion të madh ushtarak në Dukagjin, me synimin për të thyer guximin e shqiptarëve dhe për të shkatërruar strukturat organizative të UÇK-së. Vendndodhja ku u planifikua goditja ishte Gllogjani. Në atë kohë tashmë ishte bërë e ditur se në këtë zonë ishte krijuar shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit. Për armikun ky ishte një objektiv me rëndësi të veçantë strategjike. ➔



Ata mendonin se duke goditur këtë shtab dhe duke eliminuar drejtuesit e tij, do të krijonin një çarje të madhe në strukturën e UÇK-së. Njëkohësisht, ata kishin informacion se Glogjani ishte shndërruar në një nga pikat kryesore të organizimit të luftës dhe të shpërndarjes së armëve që vinin nga kufiri me Shqipërinë. Prandaj, për armikun, shkatërrimi i kësaj baze do të kishte një efekt të madh në gjithë zhvillimin e luftës. Por ata nuk e kuptuan një gjë shumë të rëndësishme: lufta për liri nuk mbështetet vetëm në baza ushtarake apo në shtabe, por mbi të gjitha në shpirtin e popullit. Dhe pikërisht këtë shpirt nuk mund ta shkatërronte asnjë ushtri. Zona e Dukagjinit në atë kohë kishte filluar të marrë gjithnjë e më shumë tiparet e një organizimi të mirëfilltë ushtarak. Njësitë e saj po organizoheshin, po krijonin struktura komanduese dhe po ndërtonin një sistem të qëndrueshëm rezistence. Kjo gjë e shqetësonte shumë armikun. Ai e dinte se nëse kjo zonë do të forcohej më tej, atëherë kontrolli mbi kufirin me Shqipërinë do të bëhej i pamundur. Dhe një kufi i hapur për furnizime do të thoshte forcim i vazhdueshëm i UÇK-së. Prandaj, për armikun, shkatërrimi i kësaj zone ishte bërë një domosdoshmëri strategjike. Operacioni u planifikua me shumë kujdes. Çdo detaj u analizua dhe çdo lëvizje u përgatit me saktësi. Synimi ishte i qartë: të asgjësohej shtabi i zonës dhe drejtuesit e tij të kapeshin të gjallë ose të eliminoreshin. Operacioni filloi në mëngjesin e 24 marsit 1998.

Gjatë natës, forcat jugosllave e serbe në sasi shumë të mëdha ishin përqendruar në periferi të fshatit. Ata kishin lëvizur në fshehtësi të madhe me shpresën se do të arrinin të kapnin në befasi luftëtarët e UÇK-së. Plani i tyre ishte të përsërisnin të njëjtin skenar që kishin përdorur në Prekaz. Por në Glogjan gjërat nuk ndodhën siç kishin planifikuar. Vëzhguesit e UÇK-së arritën të zbulojnë në kohë lëvizjet e armikut. Alarmet u dhanë menjëherë dhe njësitë morën pozicionet e tyre mbrojtëse. Kur zbardhi dita, lufta kishte filluar. Forcat serbe kishin një epërsi të madhe në numër dhe në armatim. Ata përdorën një arsenal të gjerë armësh, nga artileria deri te mjetet e blinduara e tanket. Por luftëtarët e lirisë nuk u tërhoqën. Lufta u zhvillua shtëpi më shtëpi, rrugë më rrugë, në një përballje të ashpër dhe të pabarabartë në çdo cep të Glogjanit. Megjithëse të paktë në numër, luftëtarët e UÇK-së treguan guxim dhe aftësi të jashtëzakonshme luftarake. Ata lëviznin me shkathtësi, godisnin armikun nga drejtime të papritura dhe krijonin një pështjellim të madh në radhët e tij. Në asnjë moment forcat serbe nuk arritën ta kuptonin qartë se ku ndodhej vija e frontit. Kjo ishte një nga arsyet pse operacioni i tyre filloi të dështojë. Qëllimi i luftëtarëve shqiptarë ishte i qartë: të luftonin dhe të mbijetonin për të vazhduar rezistencën. Edhe pse armiku përdori të gjitha llojet e armëve, ai nuk arriti të realizonte objektivat e planifikuara. Shtabi i Zonës Operative të Dukagjinit arriti

të shpëtojë pa humbje në drejtim dhe organizim. Ndërkohë, dëmet që u shkaktuan ishin kryesisht në infrastrukturë dhe në mjete materiale. Por forca kryesore e rezistencës mbeti e paprekur. Megjithëse forcat jugosllave e serbe, kur e panë humbjen e turpshme të tyre, siç e kanë pasur gjithnjë traditë, u sulën mbi qytetarët shqiptar të pa armatosur dhe bënë vepra kriminale duke bërë tortura e maltretime masive, ndër të cilët do të ishin edhe Rasim Selmanaj me shumë shqiptarë të tjerë, të cilët pas kësaj beteje u bënë luftëtarë të devotshëm e të dalluar të UÇK-së. Kjo betejë pati pasoja të mëdha për të dyja palët. Për armikun, ajo ishte një goditje e rëndë morale dhe profesionale. Ata e kuptuan se përballja e drejtpërdrejtë me forcat e UÇK-së nuk ishte aq e lehtë sa kishin menduar. Ndërsa për shqiptarët, ajo ishte një fitore e madhe morale. Populli pa me sytë e tij se armiku nuk ishte i pathyeshëm. Pushka shqiptare mund ta ndalte dhe ta mposhte atë. Ajo tregoi se një popull i vendosur mund t'i bëjë ballë edhe një force shumë më të madhe. Por në këtë betejë të lavdishme nuk duhet lënë në heshtje roli vendimtar i komandantit të Dukagjinit Ramush Haradinaj. Ai ishte figurë kyçe në organizimin dhe drejtimin e mbrojtjes së Glogjanit në atë betejë. Ai kontribuoi në vendosjen e njësisë në pozicione strategjike, duke shfrytëzuar terrenin për të kompensuar mungesën e epërsisë në armatim dhe forca. Ai drejtoi drejtpërdrejtë në vijën e parë çka ndikoi në rritjen e moralit

të luftëtarëve dhe në koordinimin e veprimeve gjatë përballjes. Ai udhëhoqi lëvizje të shpejta, goditje të befasishme dhe shpërndarje funksionale në terren, duke krijuar pasiguri dhe pështjellim në radhët e forcave të armikut. Ai ruajti strukturën komanduese, pasi objektiv kryesorë i armikut ishte neutralizimi i shtabit të Zonës Operative të Dukagjinit. Mbijetesa e kësaj strukture ishte një sukses strategjik, në të cilin roli i Ramush Haradinajt dhe drejtuesve të tjerë në terren, ishte thelbësor. Në këtë kontekst, roli i Ramush Haradinaj shihet si pjesë e një liderशिpi që arriti të mbajë në këmbë një nga zonat më të rëndësishme të rezistencës në fazat e hershme të luftës. Figura e Ramush Haradinajt në këtë betejë është pasqyrë e vendosmërisë për të mos u tërhequr, aftësisë për të udhëhequr në kushte të pabarabarta dhe ndikimit në konsolidimin e UÇK-së në Dukagjin duke u bërë përcaktues edhe për fitoren e Luftës së UÇK-së në të ardhmen. Fitorja e kësaj beteje krijoi një valë të madhe besimi dhe mobilizimi në gjithë Kosovën. Pas këtij operacioni, aktiviteti i UÇK-së në Dukagjin u zgjerua edhe më shumë. Zona operative mori përgjegjësi më të mëdha dhe filloi të funksionojë si një komandë e mirëfilltë territoriale. Në shumë vende u krijuan njësi të reja luftarake dhe gjithnjë e më shumë të rinj iu bashkuan radhëve të luftës për liri. UÇK-ja u bë simbol i shpresës dhe i krenarisë për gjithë rininë shqiptare. Glogjani u bë simbol i qëndresës dhe i guximit. Ngjarjet e atij operacioni

treguan se një popull që lufton për liri nuk mund të mposhet. Sot, kur kujtojmë atë betejë, ne nuk kujtojmë vetëm një përballje ushtarake. Ne kujtojmë një moment kur u provua forca e karakterit shqiptar. Një moment kur u dëshmuua se liria kërkon sakrificë, por edhe se ajo fitohet vetëm nga ata që nuk dorëzohen. Prandaj sot, duke kujtuar Glogjanin, ne nderojmë të gjithë ata luftëtarë që me guxim dhe përkushtim mbrojtën nderin dhe dinjitetin e kombit. Kujtojmë dëshmorët e asaj beteje të lavdishme Him Haradinaj, Gazmend Mehmetaj dhe Agron Mehmetaj, rënia e të cilëve kishte një ndikim të shumëfishtë pasi u bë frymëzim për rezistencë. Prandaj ata sot nuk përkujtohen vetëm si emra në histori, por si simbol i guximit, sakrificës dhe vendosmërisë për liri. Ata na lanë një amanet të madh: që ta ruajmë dhe ta forcojmë lirinë për të cilën ata luftuan. 24 marsi i vitit 1998, dita kur UÇK-ja në Glogjan fitoi betejen kundër Jugosllavisë dhe Serbisë, do të përsëritet edhe më 24 mars 1999, ditën kur NATO-ja filloi goditjet kundër Jugosllavisë e Serbisë, duke e bërë UÇK-në me forcë ajrore e duke i bërë komandantët e formacioneve të UÇK-së urdhërues dhe komandues të formacioneve të organizatës më të madhe të botës, NATO-s. Lavdi të gjithë dëshmorëve të lirisë! Lavdi luftëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës! Lavdi Glogjanit dhe gjithë Dukagjinit! Rroftë Kosova e lirë! Rroftë kombi shqiptar! Ju faleminderit!



**QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'**
TEL: 045/82 82 82

KOSOVA SONTE LUAN PËR HISTORI PËRBALLË SLOVAKISË

Kombëtarja e Kosovës në futboll luan sonte kundër Sllovakisë në kuadër të gjysmëfinalës së “play-off”-it për kualifikim në Kupën e Botës 2026. Nga kampi i Kosovës kanë shprehur optimizëm se do të dalin me rezultat pozitiv nga ballafaqimi në Bratisllavë. Selektori dhe lojtarët “dardanë” besojnë se Kosova mund ta shkruajë historinë, duke vazhduar ëndrrën për në Botëror



vendi i dytë dhe aty përfunduar. Tash jemi në ‘play-off’ dhe mund ta shkruajmë historinë. I kemi dy ndeshjet e radhës. Duhet ta kemi parasysh se Sllovakia e ka mundur Gjermaninë dhe ka cilësi. I kemi dy ndeshjet e fundit dhe do të bëjmë çmos që Kosovën ta përfaqësojmë denjësisht. Lojtarët janë të motivuar dhe kemi ekip me një shpirt luftarak”, ka thënë Foda.

Ndërsa mbrojtësi Florent

Hadërgjonaj ka theksuar se skuadra është maksimalisht e motivuar për këtë sfidë historike. “Për të gjithë ne kjo është një ndeshje historike. Kemi mundësinë të arrijmë në finale dhe të afrohem edhe më shumë me Botërorin. Jemi të motivuar maksimalisht dhe të fokusuar te kjo ndeshje. Atmosfera në ekip është fantastike dhe kjo na jep forcë shtesë”, ka thënë Hadërgjonaj. Ai ka shtuar se grupi është i bashkuar dhe kjo reflektohet

në fushë, ku secili futbollist lufton për njëri-tjetrin. “Kualifikimi në Botëror është një ëndërr e jashtëzakonshme. Kemi pasur një shans për Evropian dhe tani kemi një tjetër për Botëror. Jemi të fokusuar vetëm te gjysmëfinalja dhe besojmë se mund ta kalojmë këtë pengesë”, është shprehur ai. Mbrojtësi Kreshnik Hajrizi ka shprehur optimizëm para kësaj përballjeje, duke theksuar se ekipi është përgatitur maksimalisht. Ai ka theksuar se, pavarësisht prej vështirësive që sjell ndeshja në udhëtim, Kosova ka dëshmuar edhe më parë se di të përballlet me sfida të tilla. “Ëndërra për Botëror po afrohet. Jemi vetëm dy ndeshje larg. Është një sfidë shumë e rëndësishme dhe jemi të gatshëm ta japim maksimumin”, ka përfunduar ai.

Kujtojmë se fituesi i këtij dueli do të përballlet në finale me fituesin e ndeshjes Turqi - Rumani.

AGIM ADEMI PARALAJMËRON KOMBËTAREN: S'DUHET TË JEMI EUFORIKË, TA JAPIM 120-PËRQINDËSHIN



PRISHTINË, 25 MARS - Kryetari i Federatës së Futbollit të Kosovës (FFK), Agim Ademi, ka paralajmëruar futbollistët e kombëtares që të qëndrojnë me këmbë në tokë në duelin e gjysmëfinalës së “play-off”-it për kualifikim në Kupën e Botës kundër Sllovakisë. Ademi ka thënë se atmosfera në grup një ditë para duelit është e mirë. “Jemi të hendikepuar pa dy super-futbollistë, pa kapitenin Amir Rrahmanin dhe Leon Avdullahun, por shpresoj që edhe zëvendësuesit do të jenë po aq të përkushtuar dhe në nivel për këtë ndeshje. Secili

futbollist është mentalisht i përgatitur për këtë ndeshje dhe nuk janë euforikë. Tashmë jemi skuadër e pjekur”, ka thënë Ademi.

Ai ka thënë se i ka lutur futbollistët që të japin 120-përqindëshin e tyre në sfidën e së enjtes mbrëma. “Ne jemi të fokusuar vetëm te fusha dhe këtë herë i kam lutur futbollistët, u kam thënë atyre dhe po e them këtë publikisht: secilën pjesë na duhet ta bëjmë 120 për qind që t'i tejkalojmë të gjitha sfidat në fushë dhe në fund të dalim fitimtarë sepse është një rast i madh që na ka

ardhur e këtë shans nuk duhet ta lëshojmë”, ka thënë Ademi. I pari i FFK-së nuk do që Vedat Muriqi, sulmuesi kryesor i kombëtares, të pensionohet pa e dërguar Kosovën së paku në një Botëror e në një Evropian. “Dëshira jonë e madhe është që të bëjmë këtë hap, të shkojmë në Kupën e Botës e pastaj edhe në Evropian. Dëshira ime është që Vedati të jetë në këto dy kompeticione, por sigurisht që ai është aq i ndërgjegjshëm sado që t'ia lirojë vendin gjeneratës së re në kombëtare”, ka thënë Ademi.


Zyrtare: Salah do të largohet nga Liverpooi pas përfundimit të sezonit

Liverpool, 25 mars - Mohamed Salah ka konfirmuar se do të largohet nga Liverpooi në fund të sezonit. Salah, 33 vjeç, kishte nënshkruar me Liverpooi në vitin 2017 për 37 milionë paund nga Roma dhe që atëherë është bërë një nga lojtarët më të mëdhenj në historinë e klubit. Sulmuesi egjiptian është golashënuesi i tretë më i mirë i të gjitha kohëve të Liverpooit, me 255 gola në 435 paraqitje. Në një

deklaratë në rrjetet sociale, Salah ka thënë se ka ardhur koha për t'u larguar nga Liverpooi. “Përshëndetje të gjithëve! Fatkeqësisht, ka ardhur dita. Kjo është pjesa e parë e lamtumirës sime. Do të largohem nga Liverpooi në fund të sezonit. Nuk e kisha imagjinuar kurrë se sa thellë ky klub, ky qytet, ky popull do të bëheshin pjesë e jetës sime. Liverpooi nuk është thjesht një klub futbollit. Është

pasion, histori, shpirt. Nuk mund t'i shpjegoj fjalët kujtdo që nuk bën pjesë në këtë klub. Ne festuam fitoret, fituam trofetë më të rëndësishëm dhe luftuam së bashku edhe në kohët më të vështira. Dua t'i falënderoj të gjithë ata që ishin pjesë e këtij klubi gjatë kohës sime këtu, veçanërisht shokët e skuadrës, të kaluar dhe të tanishëm. Dhe tifozëve: nuk kam fjalë të mjaftueshme për mbështetjen

që më treguat gjatë kohës më të mirë të karrierës sime dhe për qëndresën tuaj në kohët më të vështira. Kjo është diçka që nuk do ta harroj kurrë dhe që do ta mbaj gjithmonë me vete. Largimi nuk është kurrë i lehtë. Ju më dhatë kohën më të mirë të jetës sime. Unë do të jem gjithmonë një prej jush. Ky klub do të mbetet gjithmonë shtëpia ime dhe e familjes time. Faleminderit për gjithçka! Për



shkak jush nuk do të jem kurrë vetëm”, ka thënë Slah në mesazhin e tij lamtumirës.

NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Ordinanca Stomatologjike Sapphire Dentistry” SH.P.K. pronar Alban Devaja me seli në Gjilan, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811356882 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditore - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Ordinanca Stomatologjike Sapphire Dentistry” D.O.O. Alban Devaja Gnjlane donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811356882 ujed-no imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavlji-vanja o novine.

ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Ordinanca Stomatologjike Sapphire Dentistry” L.L.C. with owner Alban Devaja with headquarters Gjilan, has come to the decision to quit its business: 811356882 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

NJOFTIM

Njoftojmë se kompania "Scrapple" SHPK nga Gjakova, me numër unik identifikues 812178045 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit. Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

NOTIFICATION

We inform all customers that the company "Scrapple" SHPK with address in Gjakova, has decided to close the business with unique identification number 812178045, and has appointed the liquidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo svu klientelu da je kompanija "Scrapple" SHPK, sa adresom Gjakovica, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 812178045, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

NJOFTIM

Njoftojmë se kompania "Buffalo Burgers" SHPK, me numër unik identifikues 811510610 ka marrë vendim për mbyllje të biznesit. Njoftojmë të gjithë bashkëpunëtorët afarist që kanë raporte Debitore-Kreditore në këtë shoqëri që të paraqiten në afatin prej 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

NOTIFICATION

We inform all customers that the company “Buffalo Burgers” SHPK, has decided to close the business with unique identification number 811510610, and has appointed the liquidator for the development of the liquidation procedure. All clients who have Credit-Debt reports in this company are notified to appear within 30 days from the date of publication in the newspaper.

OBAVEŠTENJE

Obaveštavamo svu klientelu da je kompanija “Buffalo Burgers” SHPK, odlučila da pestaje radni aktivnost sa jedinstvenim identifikacionim brojem 811510610, i imenovao likvidatora za razvoj postupka likvidacije. Svi klijenti koji imaju kreditno-debitne izveštaje u ovoj kompaniji su obavešteni da se pojave u roku od 30 dana od dana objavljivanja u novinama.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Diana Marku B.I. Gjakovë, shpall të pavlefshme numrin identifikues të biznesit me nr. 811560136 të lëshuar nga ARBK.
- Kristijan Pnishi shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.
- Lule Osmani shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12.13 të sh.m. mjekësisë “Hysni Zajmi” Gjakovë.
- Xheva Çoqaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës filoore “Zenun Çoqaj” në Gjonaj Prizren.
- Patirot Jahaj shpall të pavlefshme dëftesën e shkollës fillore “Gjergj Kastrioti Skënderbeu” Mazrek Prizren.
- Firma Lakeside Ag SH.P.K. me nr. Biznesi: 811284603 në Vermic, Prizren bënë zvogëlimin e kapitalit nga vlera 15,000,000 në vlerën 100, 000.
- Kjo iniciativë vjen si një shenjë vlerësi-mi dhe respekti për gratë, duke u ofruar atyre mundësi më të lehtë për t’u pajisur me patentë shoferi dhe për të fituar pavarësi në komunikacion.
- Për më shumë informata dhe regjistrime, të interesuarat mund të drejtohen pranë Auto Shkollës “Trimi” SH.P.K. gjatë orarit të punës.
- Milaim Sh. Hajdari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme Teknike mekanik i radiotelevizionit të shkollës “Gjin Gazulli” Prishtinë.
- Kujtim Hakaj shpall të pavlefshme diplomën e sh, profesionale “Dituria” Prizren.
- Tahir Neziri shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Kuvendi i Juniku” Junik.
- Zejnie Morina shpall të pavlefshme diplomën e gjimnazit “Xhelal Hajda Toni” Ratkoc Gjakovë.
- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.
- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm.
- Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.
- Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.



ROYAL CROWN

RC
cola

ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

Columbus, Georgia, USA
Since 1909

Columbus, Georgia, USA
Since 1909
0.5L

MEKA
HALAL FOOD

TRADITË QË NGA 1992

